



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 951/prot.
H

Elbasan, më 14.05.2018

V E N D I M

Nr. 9, datë 11.05.2018

P E R

MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMEVE TE
CIKLIT TE PARE DHE NË NJË PROGRAM PROFESIONAL PER VITIN
AKADEMIK 2018-2019

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, germa c; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, germa a, në statutin e UE "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në propozimet e njësive kryesore të UE, Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në mbledhjen e datës 11.05.2018

V E N D O S I

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për vitin akademik 2018-2019 në programet e studimit të ciklit të parë dhe në një program profesional me kohë të plotë janë **3455**, të ndara si më poshtë:
 - a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë për kandidatë brenda vendit **3065. (Tabela Nr 1)**
 - b) Kuota për program të dytë studimi **69.**
 - c) Kuota për transferim studimesh **100.**
 - d) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit **121.**
 - e) Kuota për kandidatë me statusin e personit me aftësi të kufizuar **34.**
 - f) Kuota për kandidatë me statusin e jetimit **33.**
 - g) Kuota për kandidatë me statusin Romë dhe ballkano egjiptianë **33.**

2. Shpërndarja e kuotave sipas pikave 1b; 1c; 1d; 1e; 1f kryhet nga Rektorati pas përfundimit të aplikimit nga kandidatët.
3. Ky vendim i përcillet për njohje Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Prof.dr. Skender TOPI

